



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KRYEMINISTRI

URDHËR

Nr. 253, datë 29.10.2014

PËR

**KRIJIMIN E TASK - FORCËS PËR MARRJEN E MASAVE
PËR VEPRIMTARITË NË KUADËR TË DITËS KOMBËTARE
TË PYLLËZIMIT DHE ORGANIZIMIN E FUSHATËS
KOMBËTARE TË PYLLËZIMIT**

Në mbështetje të pikës 3, të nenit 102, të Kushtetutës, dhe të nenit 12, të ligjit nr.9000, datë 30.1.2003, "Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave", me propozimin e ministrit të Mjedisit,

URDHËROJ:

1. Krijimin e Task - Forcës për marrjen e masave të menjëhershme për veprimtaritë në kuadër të Ditës Kombëtare të Pyllëzimit dhe organizimin e fushatës kombëtare të pyllëzimit gjatë sezonit dhjetor – mars për mbjelljen e fidanëve pyjorë në të gjithë vendin.
2. Task - Forca të drejtohet nga zëvendëskryeministri dhe të ketë në përbërje:
 - a) Ministrin e Mjedisit;
 - b) Ministrin e Mbrojtjes;
 - c) Ministrin e Arsimit dhe Sportit;
 - ç) Ministrin e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave;
 - d) Ministrin e Punëve të Brendshme;
 - dh) Ministrin e Zhvillimit Urban dhe Turizmit;
 - e) Ministrin e Transportit dhe Infrastrukturës;
 - ë) Ministrin e Shëndetësisë;
 - f) Ministrin e Financave.

3. Task - Forca të përcaktojë objektivat dhe të hartojë, brenda datës 30.11.2014, planin e punës, i cili t'u dërgohet për zbatim strukturave të varësive përkatëse, brenda 5 (pesë) ditëve nga data e hartimit.
4. Task - Forca mbështetet nga një sekretariat teknik nën drejtimin e drejtorit të Drejtorisë së Mbrojtjes dhe Trajtimit të Pyjeve, në Ministrinë e Mjedisit, në përbërje të të cilit të ketë përfaqësues nga ministritë e përmendura në pikën 2, të urdhrit, me qëllim hartimin dhe zbatimin e planit të miratuar të punës. Përbërja e sekretariatit përcaktohet brenda 10 (dhjetë) ditëve nga hyrja në fuqi e urdhrit.
5. Ministria e Mjedisit dhe ministritë e përmendura në pikën 2, të këtij urdhri, të venë në dispozicion të Task - Forcës bazën materiale dhe burimet njerëzore për zbatimin e planit të punës.
6. Ministria e Financave në bashkëpunim me ministritë e tjera të përcaktojë fondin e nevojshëm financiar nga buxhetet e ministrive.
7. Ngarkohen anëtarët e Task - Forcës për zbatimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë

KRYEMINISTRI

EDI RAMA